

MARS 2026

BULETINI INFORMATIV

DREJTORIA E NDIHMËS JURIDIKE FALAS

INTERVISTË E DREJTORESHËS SË PËRGJITHSHME (TË KOMANDUAR) TË DREJTORISË SË NDIHMËS JURIDIKE FALAS, ZNJ. PATRICIA POGAÇE

Drejtoresha e Përgjithshme (e komanduar) e Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas, si dhe pedagogët dhe studentët e Klinikës së Ligjit pranë universitetit “Luarasi” zhvilluan një intervistë televizive mbi rëndësinë e ofrimit të shërbimit të ndihmës juridike falas.



PATRICIA POGAÇE, DR. E DREJTORESË SË NDIHMËS JURIDIKE FALAS NE MD

TRAJNIME TË ZHVILLUARA NË KUADËR TË MARRËVESHJES SË BASHKËPUNIMIT ME UNIVERSITETET



Përfaqësues të Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas si dhe punonjësit e angazhuar pranë Qendrave të Shërbimit në Tiranë, Vlorë, Elbasan dhe Shkodër zhvilluan trajnimin mbi ndihmën juridike falas me studentët e angazhuar pranë Klinikave të Ligjit në Universitete. Gjatë trajnimit studentët u informuan mbi ndihmën juridike parësore dhe dytësore, si edhe me mundësinë e zhvillimit të praktikave tre mujore të punës pranë Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas.



TAKIMI RAJONAL I KOMISIONIT EUROPIAN PËR EFIÇENCËN NË DREJTËSI (CEPEJ)



Përfaqësues të Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas morën pjesë në workshopin me temë: “Ndihma Juridike Falas, nga kuadri ligjor te krahasueshmëria e të dhënave dhe përdorimi i tyre si pjesë e politikave”. Takimi u zhvillua në Budva, Mal të Zi me pjesëmarrjen e përfaqësuesve nga Ballkani Perëndimor dhe Evropa Lindore.

INTERVISTË MBI NDIHMËN JURIDIKE FALAS DHE RASTET E SUKSESIT



Drejtoresha e Përgjithshme (e komanduar) e Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas, znj. Patricia Pogaçe, si dhe Koordinatorja për të Drejtën e Informimit, znj. Helga Çela, ishin pjesë e emisionit “Në kohë reale” i transmetuar në Radio Televizionin Shqiptar. Gjatë këtij emisioni publiku u informua mbi ofrimin e ndihmës juridike falas, por edhe u njoh me raste suksesti të qytetarëve përfitues.

AKTIVITETE TË QENDRAVE TË SHËRBIMIT TË NDIHMËS JURIDIKE PARËSORË

QSHNJP Shkodër, më datë 18.03.2026, mori pjesë në forumin “Transparencë në Shëndetësi”, në kuadër të nxitjes së dialogut publik dhe përmirësimit të aksesit në shërbime cilësore.

QSHNJP Berat, më datë 25.03.2026, zhvilloi një aktivitet informues pranë Njësisë Administrative Poshnje, në kuadër të Ditës Botërore të Sindromës Down dhe Ditës Ndërkombëtare për Eliminimin e Diskriminimit Racor.



QSHNJP Kukës, më datë 10.03.2026, mori pjesë në një aktivitet të organizuar nga OSCE me temë “Vetëidentifikimi i pakicave kombëtare”, në kuadër të mbështetjes dhe përfshirjes së kategorive vulnerabël në aksesin në drejtësi.

QSHNJP Kukës, më datë 05.03.2026, zhvilloi një takim informues me komunitetin Rom në kuadër të 8 Marsit, Ditës Ndërkombëtare të Gruas, për prezantimin e shërbimeve të ndihmës juridike falas dhe kategorive përfituese sipas ligjit 111/2017.



QSHNJP Korçë, në datën 03.03.2026, zhvilloi një aktivitet promovues në IEVP Pojskë me gratë e privuara nga liria, në kuadër të 8 Marsit - Ditës Ndërkombëtare të Gruas.

QSHNJP Korçë, në datën 06.03.2026, mori pjesë në një takim informues, në kuadër të ndryshimeve ligjore të ligjit nr. 9669 për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare dhe forcimit të bashkëpunimit ndërinstytucional.



QSHNJP Korçë, në datën 10.03.2026, zhvilloi një takim me përfaqësuesin e UNHCR, në kuadër të mbështetjes së azilkërkuesve dhe promovimit të ndihmës juridike falas për këtë kategori.



QSHNJP Lezhë, më datë 05.03.2026, mori pjesë në aktivitetin e organizuar nga Bashkia Lezhë në kuadër të 8 Marsit, në formën e ekspozitës “Gruaja në sytë e fëmijëve”, për të evidentuar kontributin e grave në komunitet.





QSHNJP Korçë, në datën 13.03.2026, mori pjesë në një aktivitet të organizuar nga Zyra Rajonale e Avokatit të Popullit Pogradec, në kuadër të promovimit të të drejtave të komuniteteve Rom dhe Egjiptian.



QSHNJP Korçë, në datën 18.03.2026, mori pjesë në një takim të organizuar nga GTN, në kuadër të koordinimit ndërinstitucional për trajtimin e një rasti të mbrojtjes së një fëmije.



QSHNJP Korçë, në datën 19.03.2026, zhvilloi një aktivitet ndërgjegjësues në bashkëpunim me institucionet përkatëse, në kuadër të Ditës Botërore të Sindromës Down dhe promovimit të përfshirjes dhe barazisë.

QSHNJP Korçë, në datën 19.03.2026, zhvilloi një aktivitet ndërgjegjësues me nxënës, në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Eliminimit të Diskriminimit Racor dhe promovimit të diversitetit dhe barazisë.



QSHNJP Korçë, në datën 24.03.2026, realizoi një intervistë në RTSH Korça, në kuadër të informimit të publikut mbi shërbimet e ofruara nga qendra.

QSHNJP Korçë, në datën 25.03.2026, zhvilloi një takim informues me përfitues të skemës sociale në bashkëpunim me Drejtorinë e Kujdesit Social, në kuadër të informimit mbi ligjin nr. 111/2017 dhe shërbimet e ndihmës juridike falas.



QSHNJP Vlorë, në datën 09.03.2026, mori pjesë në një aktivitet të organizuar nga Qendra Vatra, në kuadër të 8 Marsit - Ditës Ndërkombëtare të Gruas dhe promovimit të barazisë gjinore dhe të drejtave të grave dhe vajzave.

QSHNJP Vlorë, në datën 24.03.2026, zhvilloi një takim ndërgjegjësues, në kuadër të Ditës Ndërkombëtare për Eliminimin e Diskriminimit Racor dhe promovimit të barazisë dhe mbrojtjes së dinjitetit njerëzor.



QSHNJP Dibër, në datën 25 mars 2026, zhvilloi një aktivitet informues në kuadër të ndërgjegjësimit të pensionistëve mbi përfitimet nga ligji nr. 111/2017 për ndihmën juridike falas.

QSHNJP Mat, në datën 10.03.2026, mori pjesë në një takim të Grupit Teknik Ndërsektorial pranë Bashkisë Mat, në kuadër të trajtimit dhe mbrojtjes së një rasti të fëmijës në nevojë, në zbatim të kuadrit ligjor për mbrojtjen e fëmijëve.

QSHNJP Mat, në datën 19.03.2026, zhvilloi një takim informues me përfaqësues të Shoqatës Kombëtare "Shpresë për të Verbërit", në kuadër të promovimit të ligjit nr. 111/2017 dhe aksesit në ndihmën juridike falas për personat me aftësi të kufizuara.



QSHNJP Elbasan, në datën 18.03.2026, mori pjesë në mbledhjen e MKR-së Elbasan, në kuadër të trajtimit të një rasti dhune në familje dhe koordinimit ndërinstitucional për mbrojtjen e viktimave.

QSHNJP Lezhë, më datë 31.03.2026, mori pjesë në workshop-in "Menaxhimi efektiv i rasteve të dhunës në familje në nivel vendor", për forcimin e praktikës së menaxhimit të rasteve në nivel vendor dhe diskutimin e dilemave profesionale sipas Ligjit Nr. 11/2026.



QSHNJP Elbasan, në datën 24.03.2026, zhvilloi një aktivitet informues në formën “street law”, në kuadër të Ditës Ndërkombëtare për Eliminimin e Diskriminimit Racor dhe promovimit të ligjit nr. 111/2017 për ndihmën juridike falas.



QSHNJP Gjirokastrë, në datën 09.03.2026, zhvilloi një aktivitet simbolik në bashkëpunim me institucionet partnere, në kuadër të 8 Marsit - Ditës Ndërkombëtare të Gruas dhe promovimit të rolit dhe të drejtave të grave në shoqëri.



QSHNJP Përmet, në datën 13.03.2026, në bashkëpunim me QSHNJP Gjirokastrë, zhvilloi një takim informues në Bashkinë Tepelenë, në kuadër të promovimit të ligjit nr. 111/2017 dhe forcimit të bashkëpunimit ndërinstitucional për aksesin në ndihmën juridike falas.



QSHNJP Kurbin, në datën 13.03.2026, zhvilloi një tryezë diskutimi në bashkëpunim me institucionet vendore, në kuadër të forcimit të bashkëpunimit për referimin e rasteve që kanë nevojë për ndihmë juridike falas.

QSHNJP Kurbin, në datën 19.03.2026, zhvilloi një takim me përfaqësues të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në kuadër të prezantimit të legjislacionit për mbrojtjen nga diskriminimi dhe forcimit të bashkëpunimit ndërinstitucional.



QSHNJP Kurbin, në datën 19.03.2026, zhvilloi një aktivitet informues në bashkëpunim me institucionet përkatëse, në kuadër të informimit të qytetarëve mbi shërbimet e ndihmës juridike falas dhe legjislacionin për mbrojtjen nga diskriminimi.

QSHNJP Kurbin, në datën 19.03.2026, zhvilloi një takim ndërgjegjësues me nxënës, në kuadër të promovimit të barazisë, parandalimit të diskriminimit dhe informimit mbi përfitimet nga ligji nr. 111/2017 për ndihmën juridike falas.



QSHNJP Fier, më datë 05.03.2026, zhvilloi një aktivitet informues dhe sensibilizues me stafin dhe nxënësit e shkollës “Thoma Sota” Fier, në kuadër të rritjes së ndërgjegjësimit mbi ligjin për ndihmën juridike falas.

QSHNJP Fier, më datë 18.03.2026, mori pjesë në një aktivitet ndërinstitucional pranë Qendrës Shëndetësore Dërmenas, për identifikimin dhe referimin e rasteve të dhunës me bazë gjinore.



QSHNJP Fier, më datë 19.03.2026, zhvilloi një aktivitet informues në komunitetin e fshatit Vajkan, në kuadër të Ditës Ndërkombëtare për Eliminimin e Diskriminimit Racor.

QSHNJP Fier, më datë 25.03.2026, zhvilloi një takim sensibilizues me stafin e Qendrës Multifunktionale “Horizont”, në kuadër të Ditës Botërore të Sindromës Down.



QSHNJP Durrës, më datë 13.03.2026, zhvilloi një aktivitet informues pranë Njesisë Administrative Katund i Ri, në zbatim të kalendarit vjetor të aktiviteteve dhe rritjes së ndërgjegjësimit mbi ndihmën juridike falas.



QSHNJP Durrës, më datë 13.03.2026, u përfshi në një intervistë në median e shkruar "Revokult", në kuadër të promovimit të shërbimeve të ndihmës juridike falas.



QSHNJP Durrës, më datë 30.03.2026, zhvilloi një takim pune me Kryetarin e Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, në kuadër të forcimit të bashkëpunimit ndërinstitucional dhe përmirësimit të aksesit në drejtësi.

QSHNJP Durrës, më datë 31.03.2026, mori pjesë në inaugurimin e ambienteve miqësore për fëmijët pranë Shërbimit Përmbarrimor Durrës, në kuadër të përmirësimit të shërbimeve për qytetarët.

QSHNJP Tropojë, në kuadër të Ditës Botërore të Sindromës Down, zhvilloi një takim ndërgjegjësues me një të ri me këtë sindromë, për promovimin e përfshirjes dhe të drejtave të personave me aftësi ndryshe.



QSHNJP Tropojë, në kuadër të Ditës Ndërkombëtare kundër Diskriminimit Racor, zhvilloi një takim pranë Shërbimit Social të Bashkisë Tropojë, për rritjen e ndërgjegjësimit dhe mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve rom/egjiptian.



QSHNJP Tropojë, më datë 27.03.2026, zhvilloi një aktivitet informues në shkollën 9-vjeçare "Beslidhja e Malësisë", në kuadër të edukimit ligjor dhe promovimit të ndihmës juridike falas.



QSHNJP Tropojë, më datë 29.03.2026, zhvilloi një takim informues me banorë të fshatit Sopot, në kuadër të rritjes së aksesit në drejtësi në zonat rurale.

QSHNJP Tropojë, në kuadër të kalendarit të aktiviteteve, zhvilloi një takim informues me persona që përfitojnë nga pagesa për aftësinë e kufizuar, për rritjen e ndërgjegjësimit mbi të drejtat dhe aksesin në ndihmë juridike falas.



QSHNJP Tropojë zhvilloi një takim me Administratorin e Njesisë Administrative Bujan dhe stafin përkatës, në kuadër të forcimit të bashkëpunimit ndërinstitucional dhe orientimit të qytetarëve drejt përfitimit të ndihmës juridike falas.



QSHNJP Përmet, më datë 24.03.2026, zhvilloi një aktivitet informues me nxënësit e shkollës "Nonda Bulka", në kuadër të Ditës Ndërkombëtare për Eliminimin e Diskriminimit Racor dhe rritjes së ndërgjegjësimit mbi të drejtat e njeriut.

QSHNJP Shkodër, më datë 19.03.2026, mori pjesë në një takim me temë "Siguria Digjitale është Siguria e Grave", në kuadër të rritjes së ndërgjegjësimit mbi mbrojtjen dhe të drejtat e grave.



QSHNJP Lezhë, më datë 25.03.2026, mori pjesë në aktivitetin e projektit "Mbështetje për barazinë gjinore, të drejtat dhe fuqizimin ekonomik të grave rurale në veri të Shqipërisë" (AID 12819), për ndarjen e dokumentit të përgatitur me pjesëmarrjen e grave dhe vajzave të komuniteteve rurale.

